



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSËMIE E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Nr. 9528 / 1 Prot.

Tiranë, më 24.12.2015

Drejtuar: ZNJ. ANA RAFTI
DREJTOR I MARRËDHËNIEVE ME QYTETARIN

Tiranë

Për dëjani Z. AFRIM PACOLLI, PRESIDENT
"MABETEX GROUP, LUGANO"
Rruga "I Rugova" Nd. 28, H 9, Ap. 28

Tiranë

Lënda: Kthim përgjigje

E nderuar Znj. Rafti,

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 5834/1, datë 07.12.2015, ju informojmë se në përgjigje të interesimit të shprehur nga shoqëria "Mabetex Group", Lugano, për të investuar në drejtim të zhvillimit të industrisë së turizmit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, duke u bazuar në korrespondencën me institucionet përgjegjëse për marrjen e informacionit të kërkuar nga shoqëria, ka informuar shoqërinë për sa më poshtë:

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje me shkresën nr. 5648/1, datë 22.10.2015, ka informuar se sipërfaqja totale e zonës që shoqëria kërkon të zhvillojë është 4978.53 ha, e ndarë 4790.9 ha shtet, 47.23 ha private, 40.8 ha tokë përdorim, 78.8 koncesion, 21.2 ha nën juridiksionin e Bashkisë Divjakë.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave është shprehur se në këtë zonë nuk ka sipërfaqe të dhëna me koncesion.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit me shkresën nr. 2821, datë 04.11.2015, ka përcaktuar në hartë zonat për mundësinë e zhvillimit të turizmit, si zona urbane, duke theksuar se ky projekt duhet implementohet, në përputhshmëri të investimit me objektivat, vizionin dhe politikat e instrumentit të planifikimit të territorit dhe të zonave të mbrojtura, duke marrë parasysh mbrojtjen e biodiversitetit në përmirësim të kushteve aktuale natyrore dhe në përputhshmëri me sektorin bujqësor dhe agroturistik.

Sa më lart, në vijim të informacionit të mësipërm, shoqërisë i është vënë në dispozicion harta e dërguar nga ZVRPP, Lushnje dhe AKPP Tiranë dhe i është kërkuar hartimi i projektit dhe studimit, në zbatim të legjislacionit në fuqi për Investimet Strategjike, ligjit për Turizmin dhe Planifikimin të Territorit.

Faleminderit për mirëkuptimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

FREDERIK SEITI